



Nr. 28/12  
Datë: 25.10.2012

Në mbështetje të nenit 3 (paragrafi 1), nenit 24 dhe nenit 49 ( paragrafi 1. dhe 2 ) të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 3 (paragrafi 1), nenit 7 (paragrafi 1), nenit 65 të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, nenin 7 (paragrafi 6) të Udhëzimit Administrativ 05/2012-M.P.B për Komisioni e Shqyrtimit të Ankesave, Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë mori këtë:

### V E N D I M

1. Urdhërohet Agjencia për Regjistrim Civil të rishqyrtoj të gjitha lëndët e trajtuara nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga ana e [REDACTED] - Kryesues i Komisionit për shqyrtimin e Ankesave, në ankesat (lëndët) me numër 01/012, 02/012, 03/012, 04/012, 05/012, 06/012, 07/012, 08/012, 8/012, 9/012. Këto vendime të nxjerra në periudhën kohore 01 Janar 2012 deri më 01 Mars 2012.
2. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të lajmërohet me shkrim brenda tetë (8) ditëve lidhur me zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

### Arsyetim

Gjatë inspektimit të bërë në Agjencinë për Regjistrim Civil, respektivisht në komisionin për ankesa dhe parashtesa (në tekstin e mëtejshëm komisioni), me qëllim të mbikëqyrjes së ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga ana e Komisionit, kemi shqyrtuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale në periudhën kohore nga data 01 Janar i vitit 2012 deri 01 Mars 2012.

Gjate shqyrtimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale është konstatuar se përpunimi i të dhënave është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 3 (paragrafi 1), nenit 7 (paragrafi) të Ligjit Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile.

Në bazë të vendimit nr. 1040 të datës 07.11.2006 të Ministrisë së Shërbimeve Publike me të cilin emërohet Komisioni i Përhershëm për Shqyrtimin e Ankesave në Departamentin e Gjendjes Civile me [REDACTED] kryesues i komisionit në përbërje prej tre anëtarëve. Kryesuesi i komisionit ka pasur për detyrë të udhëheq punën e komisionit, të organizoj mbajtjen e takimeve, mbajtjen e shënimeve, mbarëvajtjen e punës dhe hartimin e raporteve.

( 1 )

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE	
Nr. Urdh. Urdh. Nr. Urdh. Vendi	01
Nr. Prot. Prot. Nr. Prot. Nr.	186
Nr. ifaqesë Broj stranic No. pages	02
Data Datum Date	25/10/2012
PRISHTINE/JA	

Gjatë shqyrtimit të ankesave- lëndëve me numër 01/012, 02/012, 03/012, 04/012, 05/012, 06/012, 07/012, 08/012, 8/012, 9/012, kryetari i komisionit [REDAKTUAR] ka organizuar dhe ka nxjerr vendime me praninë e vetëm një anëtari të Komisionit (vetëm njëri anëtar gjatë gjithë punës së Komisionit), që është në kundërshtim me nenin 7 (paragrafi 6) të Udhëzimit Administrativ 05/2012-MPB për Komisioni e Shqyrtimit te Ankesave.

Komisioni me rastin e shqyrtimit të ankesave-lëndëve 01/012, 02/012, 03/012, 04/012, 05/012, 06/012, 07/012, 08/012, 8/012, 9/012, ka nxjerr vendime në pajtim me "nenin 5.4 të rregullores së UNMIK-ut 2001/19". Neni në fjalë rregullon detyrat dhe përgjegjësi e Sekretarëve të Përhershëm të ministrive të cilët mbajnë përgjegjësi drejtpërdrejtë ndaj ministrit përkatës, si dhe Kryeshefave ekzekutivë të Agjencive ekzekutive që mbajnë përgjegjësi drejtpërdrejtë ndaj Ministrit përkatës apo autoriteteve tjera të përcaktuara me ligjet përkatëse për themelimin e Agjencive ekzekutive.

Komisioni i ka bazuar vendimet e saj në dispozitat ligjore të cilat rregullojnë funksionet dhe përgjegjësit e Sekretarëve të Përhershëm dhe Kryeshefave ekzekutiv, e jo të Komisionit në fjalë apo shqyrtimit të ankesave, që do të thotë se vendimet janë bazuar në dispozitat ligjore që nuk rregullojnë punën e komisionit apo shqyrtimit të ankesave.

Në bazë të dispozitës të nenit 65 të Ligjit 04/L-003 për Gjendjen Civile, i cili ka hyrë në fuqi më 23 qershor 2011, i cili e shfuqizon Ligjin Nr. 2004/46 për Regjistrat e Gjendjes Civile dhe Ligjit Nr. 02/1-126 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/46 për Regjistrat e Gjendjes Civile, si dhe dispozitat tjera në lidhje me gjendjen civile në kundërshtim me këtë Ligj. Komisioni jo vetë që nuk ka zbatuar nenin 65 të Ligjit 04/L-003 për Gjendjen Civile, por ka vazhduar të nxjerr vendime kundërligjshme duke mos përfillur edhe dispozitat tjera ligjore si nenin 3 (paragrafi 1) me të cilën obligohet që të gjitha aktivitetet të ndërmerren në pajtueshmëri të plote me ligjet dhe aktet nënligjore, duke orientuar me këtë rast në nenin 7 për respektimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale të specifikuara me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

*Për të siguruar përpunim të ligjshëm të të dhënave, Agjencia e Regjistrimit Civil duhet të rishqyrtoj të gjitha lëndët e lartcekura, duke garantuar me këtë rast të drejtën e subjektit për korrigjimin e të dhënave personale, në harmoni me nenin 24 të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

#### Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Zv. Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror

*Mentor Hoxhaj*  
Mentor Hoxhaj

Vendimi i dërgohet:

- Agjencia për Regjistrim Civil.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë.
- Arkivit të Agjencisë.

